



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/04 - 159131/23, më 02. 08. 2023

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008) dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

1. **Miratohet** themelimi i grupit teknik për projektin "Prishtina një qytet pa barriera".
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, grupi teknik është në këtë përbërje:
 1. Habib Qorri, Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë, anëtar;
 2. Premtim Fazliu, Drejtoria për Mirëqenie Sociale, anëtar;
 3. Valbona Berisha, Drejtoria për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, anëtare;
 4. Halil Halili, Drejtoria për Shërbime Publike, anëtar;
 5. Atdhe Berisha, Drejtoria e Inspektionit.
3. Detyrë e grupit teknik të cekur si në pikën 2 të këtij Vendimi, është evidentimi i lokacioneve të cilave ju mungon qasja për personat me aftësi të kufizuara dhe koordinimi i aktiviteteve për planifikimin dhe ndërhyrjet në pjesë të ndryshme të institucioneve publike dhe të infrastrukturës në Kryeqytet, për lehtësimin e lëvizjes për personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe personat e moshuar.
4. Grupi teknik do të raportojë dhe përgjigjet grupit strategjik i cili është në nivel të drejtorëve dhe këshilltareve të Kryetarit të Kryeqytetit
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

U dorëzohet:

- Anëtarëve të grupit teknik;
- Qendrës për Shërbim me Qytetarë;
- Në dosje.

